



**FEDERATA E TENISIT E KOSOVËS  
TENISKA FEDERACIJA KOSOVA  
KOSOVO TENNIS FEDERATION**

Në bazë të nenit 11 të Statutit të Federatës së Tenisit të Kosovës të datës 17 Nëntor 2022, Bordi i Federatës miraton këtë:

## **RREGULLORE #06**

**PËR**

**ÇMIMET VJETORE DHE PËR SHËRBIM NDAJ SPORTIT**

**VERSIONI 1.1**



## PËRMBAJTJA

1.	Qëllimi dhe fushëveprimi .....	2
2.	Komisioni përzgjedhës për më të mirët e vitit .....	2
3.	Çmimet vjetore .....	2
4.	Tenistët e vitit .....	3
5.	Gjyqtari i vitit .....	4
6.	Trajneri i vitit .....	4
7.	Klubi i vitit.....	5
8.	Punonjësi i vitit .....	5
9.	Turneu i vitit.....	6
10.	Çmimi për shërbim ndaj sportit.....	6
11.	Ceremonia .....	7
12.	Dispozitat përfundimtare .....	7

## VERSIONET E DOKUMENTIT

Versioni	Në fuqi	Aprovoi / Data e aprovimit	Ndryshimet
1.0	01.01.2020	Bordi / 15.01.2020	-
1.1	24.03.2022	Bordi/ 23.03.2022	4.7.1. Çmimi Tenisti i vitit vendor 4.7.2. Çmimi Tenisti i vitit ne arenën ndërkombëtare 4.7.3. Çmimi kryesorë Tenisti dhe Tenistja e vitit



## 1. Qëllimi dhe fushëveprimi

- 1.1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të caktojë kriteret dhe parimet që do të merren parasysh për përzgjedhjen e më të mirëve për një vit kalendarik si dhe kriteret për çmimet për shërbime ndaj sportit të tenisit. Njëkohësisht përcaktohen kategoritë dhe grupmoshat për të cilan ndahen çmimet, si dhe shpërblimet që mund të jepen.
- 1.2. Subjekt i kësaj rregulloreje janë klubet, organizatat dhe personat që kanë bërë arritjet më të mëdha në fushën e tenisit, qoftë si tenistë, trajnerë, administratorë, donatorë, promovues të sportit në përgjithësi dhe të tenisit në veçanti.

## 2. Komisioni përzgjedhës për më të mirët e vitit

- 2.1. Më të mirët e vitit përzgjedhen nga Komisioni përzgjedhës duke u mbështetur në kriteret dhe parimet e përcaktuara me këtë rregullore.
- 2.2. Anëtarët e komisionit emërohet nga Bordi i FTK-së çdo vit, me përbërje kryesuesin dhe dy anëtarë të tjerë.
- 2.3. Komisioni kryen punën brenda afateve të caktuara nga Bordi.

## 3. Çmimet vjetore

- 3.1. Çmimet standarde dhe diciplinat për të cilat ato jepen janë si në vijim:

ÇMIMI	DICIPLINA
Shpresat e vitit	Topi i Kuq / Portokalltë / Gjelbër
Tenisti i vitit për	Grupmoshën U12 / U14 / U16 U18 / 35+ / 55+ Kategorinë “A”
Gjyqtari i vitit	-
Punonjësi i vitit	-
Trajneri i vitit	-
Klubi i vitit	-
Turneu i vitit	-

- 3.2. Çmimet e veçanta, varësisht propozimeve dhe vlerësimit nga ana e Komisionit, mund të jepen për arritje apo kontribut të theksuar në fushën e sportit apo tenisit. Personat mund të propozohen nga palët e treta, ose të vetëkandidohen, duke i shtjelluar me shkrim hollësisht arsyet dhe duke faktuar gjërat.



#### 4. Tenistët e vitit

- 4.1. Çmimet vjetore jepen njësoj për të dyja gjinitë.
- 4.2. Vetëm tenistët shtetas të Republikës së Kosovës mund të jenë përfitues sipas këtij neni.
- 4.3. Tenistët që mund të për zgjedhen duhet të kenë fituar së paku dy (2) turne në garat zyrtare të Federatës ose të kenë arritur në gjysmëfinale (ose më shumë) në garat e Tennis Europe / ITF.
- 4.4. Turnetë e Federatës që kanë pasur më pak se katër (4) tenistë në grupmoshë / gjini të caktuar, nuk merren parasysh për qëllime të kësaj rregulloreje.
- 4.5. Nuk mund të për zgjedhet asnjë tenist i cili ka ndëshkime apo penalizime madhore diciplimore të vlefshme gjatë atij viti kalendarik.
- 4.6. Grupmosha ROG

Në kategorinë ROG do të ketë vetëm shpresa, dhe mund të zgjedhen 2 deri në 4 tenistë të cilët do të shpërblehen me mirënjohje varësisht arritjeve në garat zyrtare të Federatës, sipas këtyre prioriteteve:

- a. Numri i turneve kampion;
  - b. Raporti total Fitore/Humbje;
  - c. Numri i turneve finalist;
  - d. Numri i turneve gjysmëfinalist;
  - e. Raporti Fitore/Humbje në grupet Round Robin;
- 4.7. Grupmoshat e tjera

##### 4.7.1. Çmimi Tenisti i vitit vendor

Për kategorinë “A”, grupmoshat e juniorëve (U12-U18), dhe grupmoshate e veteranëve (35+ dhe 55+), do të merren parasysh një gërshetim i elementeve në vijim:

- a. Të arriturat në turnetë e Federatës;
- b. Ranglista zyrtare në fund të vitit;
- c. Ndeshjet Ballë-për-ballë;
- d. Raporti i përgjithshëm Fitore/Humbje.



#### 4.7.2. Çmimi Tenisti i vitit ne arenën ndërkombëtare

Tenistët mund të kualifikohen për këtë çmim vetëm nëse plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a. Vetëm tenistët shtetas të Republikës së Kosovës mund të jenë përfitues sipas këtij neni.
- b. Nëse tenisti ka arritur në së paku dy (2) turne e më shumë në gjysmëfinale e më lartë në single dhe në finale e më lartë në double të turneve Tennis Europe/ITF Juniors ose në Kampionate Evropiane, Botërore, Olimpikë.

Për grupmoshat e juniorëve (U12-U18), për çmimin Tenisti i vitit në arenën ndërkombëtare do të merren parasysh një gërshetim i elementeve në vijim:

- a. Të arriturat domethënëse në Kampionate Evropiane, Botërore, Olimpikë;
- b. Të arriturat domethënëse në turnetë ndërkombëtare;
- c. Ranglista zyrtare në fund të vitit;
- d. Numri i turneve që kanë marrë pjesë në turne ndërkombëtarë;
- e. Raporti i përgjithshëm Fitore/Humbje.

#### 4.7.3. Çmimi kryesorë Tenisti dhe Tenistja e vitit

- a. Vetëm tenistët shtetas të Republikës së Kosovës mund të jenë përfitues sipas këtij neni;
- b. Merren parasysh vetëm rezultatet në kategorinë Adults në Billie Jean King Cup/ Davis Cup, WTA/ATP, ITF Pro, turnet e Federatës;
- c. Niveli i turneut në të cilin kanë arritur sukses.



## 1. Gjyqtari i vitit

- 1.1. Vetëm gjyqtarët shtetas të Republikës së Kosovës mund të jenë përfitues sipas këtij neni.
- 1.2. Kandidatët mund të nominohen qoftë vetë qoftë nga Këshilli i Referëve.
- 1.3. Në përzgjedhjen e gjyqtarit të vitit shqyrtohen elementet në vijim:
  - a. Numri i turneve të mbikëqyrura / referuara gjatë vitit;
  - b. Cilësinë e referimit dhe profesionalizmin e shfaqur (bazuar në notat e fituara, nëse ka);
  - c. Angazhimin e tyre në turnet ndërkombëtar;
  - d. Përqafimin e teknologjisë dhe / ose avancimet në licencim; dhe
  - e. Çfarëdo elementi tjetër që mund të vlerësohet si relevant nga Komisioni.

## 2. Trajneri i vitit

- 2.1. Vetëm trajnerët shtetas të Republikës së Kosovës mund të jenë përfitues sipas këtij neni.
- 2.2. Kandidatët mund të nominohen qoftë vetë qoftë nga Këshilli i Trajnerëve.
- 2.3. Në përzgjedhjen e trajnerit të vitit shqyrtohen pikët për elementet në vijim:
  - a. Ngritja profesionale (certifikimi) brenda vitit, vlerësohet me 10 pikë;
  - b. Puna e mbështetur në plan program, vlerësohet me 20 pikë;
  - c. Numri i më të mirëve që trajneri ka për grupmoshë dhe gjini të caktuar mund të vlerësohet me maksimum 70 pikë duke marrë parasysh pikët në tabelën në vijim:

DICIPLINAT (M / F)	VENDI I	VENDI II
Kampionati Ekipor	3.6	2.0
Topi i Kuq	1.8	0.8
Topi i Portokalltë	1.8	0.8
Topi i Gjelbër	1.8	0.8
Grupmosha U12	2.0	1.0
Grupmosha U14	2.3	1.3
Grupmosha U16	2.6	1.6
Grupmosha U18	2.9	1.9
Kategoria "A"	3.8	2.2

- d. Njëzet (20) bonus pikë mund t'i përfitojë trajneri (selektori) që arrin vendin e parë në grup në Davis Cup ose Fed Cup;
- e. Njëzet (20) bonus pikë mund t'i përfitojë trajneri (selektori) tenisti i të cilit arrin në gjysmëfinale ose më lartë në Kampionate Evropiane, Botërore ose Olimpikë; dhe
- e. Çfarëdo elementi tjetër që mund të vlerësohet si relevant nga Komisioni.

Ne rast se dy e më shumë trajnerë kanë rezultate të barabarta përparsi ka trajneri me nivel të licencimit më të lartë.



### 3. Klubi i vitit

- 3.1. Vetëm klubet që i kanë kryer obligimet ndaj Federatës mund të jenë përfitues sipas këtij neni.
- 3.2. Klubet mund të nominohen qoftë vetë qoftë nga palët e treta.
- 3.3. Në përzgjedhjen e klubit të vitit shqyrtohen pikët për elementet në vijim:
  - a. Klubi që ka dhe zbaton plan zhvillimor e financiar, vlerësohet me 10 pikë;
  - b. Klubi që auditon pasqyrat financiare, vlerësohet me 10 pikë;
  - c. Klubi që mban mbledhje të rregullta të kryesisë, vlerësohet me 5 pikë;
  - d. Klubi që rregullisht e raporton anëtarësinë në Federatë, vlerësohet me 5 pikë;
  - e. Numri i më të mirëve që klubi ka për grupmoshë dhe gjini të caktuar mund të vlerësohet me maksimum 70 pikë duke marrë parasysh pikët në tabelën në vijim:

DICIPLINAT (M / F)	VENDI I	VENDI II
Kampionati Ekipor	3.9	2.3
Topi i Kuq	1.7	0.7
Topi i Portokalltë	1.7	0.7
Topi i Gjelbër	1.7	0.7
Grupmosha U12	2.0	1.0
Grupmosha U14	2.3	1.3
Grupmosha U16	2.6	1.6
Grupmosha U18	2.9	1.9
Kategoria "A"	3.8	2.2

### 4. Punonjësi i vitit

- 4.1. Punonjës i vitit mund të shpallet cilido punonjës, aktivist apo vullnetar, qoftë në strukturat e Federatës apo të klubeve, i cili ka punuar me zell të veçantë gjatë vitit.
- 4.2. Punonjësi mund të vetëkandidohet ose të nominohet nga personat e tretë. Në të dyja rastet arsyet duhet shtjelluar hollësisht dhe me shkrim.



## 5. Turneu i vitit

- 5.1. Turneu i vitit mund të shpallet cilido turne i organizuar në territorin e Republikës së Kosovës.
- 5.2. Drejtorët e turneve mund të vetëkandidohen ose të nominohen nga personat e tretë. Në të dyja rastet arsyet duhet shtjelluar hollësisht dhe me shkrim.

## 6. Çmimi për shërbim ndaj sportit

- 6.1. Personat që kanë bërë shërbim të gjatë dhe të dalluar për lojën e tenisit, mund të propozohen nga anëtarësia e Federatës (klubet ose shoqatat) ose nga Bordi Ekzekutiv për një çmim.

Kategoritë e mëposhtme kanë të drejtë të propozohen:

- a. **Administratorët:** Personat që kanë kaluar mbi 25 vjet në administrim të Federatës si: President, Sekretar i Përgjithshëm, anëtar i Bordit, anëtar i këshillave të ndryshme të Federatës, të një klubi, të shoqatës së referëve ose të shoqatës së trajnerëve;
  - b. **Lojtarët:** Ata që kanë mbi 25 vjet lojë zyrtare aktive ose që kanë përfaqësuar shtetin në së paku 10 cikle të Davis Cup ose Fed Cup;
  - c. **Gjyqtarët:** Gjyqtarët me mbi 20 vjet angazhimi aktiv ose që kanë përfaqësuar shtetin ndërkombëtarisht në cilësinë e gjyqtarit për së paku 12 vjet;
  - d. **Trajnerët dhe selektorët:** për një kontribut të gjatë dhe të jashtëzakonshëm në mësimin e tenisit prej mbi 20 vjet, apo përzgjedhës në Davis Cup ose Fed Cup për së paku 10 cikle.
  - e. **Të tjerët:** Një person në vit për kontribut të gjatë dhe të jashtëzakonshëm në lojën e tenisit në nivelin kombëtar.
- 6.2. Propozimet do të dorëzohen me shkrim, duke arsyetuar hollësisht dhe faktuar nominimin, së paku dy muaj para kuvendit vjetor.
  - 6.3. Nominimet fillimisht shqyrtohen nga Bordi. Nëse propozimet ay gjejnë përkrahje, atëherë ato do të paraqiten në Kuvendin e radhës për votim, ku duhet të mbështetet prej së paku 80% të delegatëve.





## 7. Ceremonia

- 7.1. Ceremonia e laureatëve të vitit do të mbahet në muajin dhjetor të secilit vit. Nëse kjo rezulton e pamundshme ajo duhet të mbahet më së largu në janar të vitit pasues.
- 7.2. Data e mbajtjes së ceremonisë duhet bërë e ditur së paku 10 ditë përpara.
- 7.3. Ftesat duhet dërguar tek mediet elektronike dhe të shkruara për ngjarjen, tek sponsorët, dhe tek KOK-u dhe dikasterët e sportit të nivelit qendror dhe atë lokal.
- 7.4. Mirënjohjet, të cilat duhet të jenë në formë të suvenirëve, duhet ndarë për:
  - a. Përkujtimet (post-mortem);
  - b. Institucionet në nivel lokal dhe qendror;
  - c. Sponsorët e Federatës apo trupave të saj;
  - d. Përkrahësit e tjerë jo-financiarë;
  - e. Fituesit e çmimeve.
- 7.5. Varësisht mundësive financiare dhe/ose sponsorizimit specifik për ngjarjen, me vendim të Bordit mund të shpërndahen edhe dhurata jo-monetare; ndërkaq, me përjashtim të tenistëve fitues në kategoritë nën 18 vjeç, mund të jepen shpërblime monetare për fituesit e tjerë të çmimeve.

## 8. Dispozitat përfundimtare

- 8.1. Kjo rregullore hyn në fuqi nga cikli i laureatëve të vitit 2020.
- 8.2. Interpretimin final për këtë rregullore e bën Bordi i Federatës.

**Jeton Hadergjonaj**  
Kryetar  
Federata e Tenisit e Kosovës

Prishtinë, 17 Nëntor 2022

